



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:036261
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637080

KPPP.nr.222/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, kundër debitorit “Newco Ferronikeli Complex” L.L.C, me numër të biznesit 70268073 dhe numër unik identifikues 810507444, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” ShPK me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.306/2023 të datës 19.12.2023 të Përmbartuesit Privat Isak Islami me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Newco Ferronikeli Complex” L.L.C, me numër të biznesit 70268073 dhe numër unik identifikues 810507444, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” ShPK me seli në Prishtinë i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.306/2023 të datës 19.12.2023 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me datë 19.12.2023, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.306/2023 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartues, Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr.01/50-08/2023GJ, të datës 15.11.2023 me të cilin është obliguar debitori që në emër të masës

ndëshkimore në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'i bëj pagesën kreditorit në shumën prej 500.00€ (pesëqind Euro).

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është lëshuar ky urdhër nuk është dokument që i plotëson kushtet për përmbartim sipas Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP-së) ashtu siç edhe ceket me dispozitat e këtij ligji.

Tutje ka shtuar se sipas nenit 38, par.1 të LPP-së në mënyrë shprehimore thuhet se *''Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartim...''* e që sipas tij në rastin konkret nuk është plotësuar ky kusht me arsyen se dokumenti i bashkëngjitur në propozim për përmbartim nuk është në origjinal e as i noterizuar, nuk është i qartë objekti i përmbartimit e as shuma specifike dhe si rrjedhojë nuk mundë të ekzekutohet.

I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit dhe të anulohet në tërësi si kundërligjshëm urdhri përmbartimor i përmbartuesit privat P.nr.306/2023 të datës 19.12.2023

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se përmbartuesi me urdhrin përmbartimor ka vërtetuar se vendimi i kreditorit është dhënë në procedurë administrative dhe si i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë. Më tej ka shtuar se vendimi i tillë është i besueshëm, i përmbartueshëm dhe i ekzekutueshëm dhe se ushtrimi i padisë në konflikt administrativ pranë gjykatës nuk e ndalë ekzekutimin e vendimit.

I ka propozuar gjykatës që ta hedhë propozimin e debitorit si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i

pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Me nenin 22 të LPP-së, në paragrafin 1 nën paragrafin 2 është përcaktuar se dokumente përmbaruese janë *“vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative...”*. Gjithashtu neni 23 paragrafi 2 i LPP-së ka përcaktuar se *“Vendim i organit administrativ, sipas këtij ligji konsiderohet vendimi dhe konkluzioni i dhënë në procedurë administrative nga organi ose shërbimi administrativ apo nga personi juridik i ngarkuar me autorizime publike...”*, kurse neni 24 paragrafi 3 i LPP-së ka paraparë se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*.

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin e Inspektoratit të Punës Nr.01/50-08/2023GJ të datës 15.11.2023 në bazë të së cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata gjeti se Vendimi Nr.01/50-08/2023GJ i datës 15.11.2023 i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*, pasi në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimi Nr.01/50-08/2023GJ i datës 15.11.2023 i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”*, dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin*

për përmbareshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”, ngase Vendimi Nr.01/50-08/2023GJ i datës 15.11.2023 i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është dorëzuar në origjinal, si dhe është bërë i ekzekutueshëm, fakt që vërtetohet nga klauzola e përmbareshmërisë në vendimin e lartcekur.

Gjykata e vlerësoi pretendimin e debitorit se ka ushtruar padi në gjykatë për anulimin e vendimit të kreditorit-Inspektoratit të Punës, mirëpo pretendimin e tillë e gjeti si të pabazuar, ngase në bazë të nenit 22 par.1 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, përcaktohet se *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”,* dhe konform kësaj dispozite ligjore vendimi i tillë i plotëson tiparet e përmbareshmërisë, dhe si rrjedhojë nuk ka asnjë pengesë për zbatimin e përmbareshmërisë.

Andaj, meqenëse në këtë çështje përmbareshmërisë gjykata vlerëson përshtatshmërinë e dokumentit përmbareshmërisë sipas dispozitave të zbatuara ligjore, nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.222/24 me datë 26.04.2024

Gjyqtari

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.